



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2017

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e lartë në Republikën e Shqipërisë, viti akademik 2017-2018, se fillimisht ata duhet të ndjekin procedurën e njësimit të diplomave të shkollës së mesme, për vazhdim studimesh ne Institucionet e Arsimit të Lartë.

Për tu informuar për procedurën që duhet ndjekur, aplikantët duhet të lexojnë udhëzimin nr.14 datë 10.05.2017 për njësimin e diplomave.

Formulari, **Kërkesë për aplikim për njësimin e diplomës së shkollës së mesme**, që duhet plotësuar dhe dorëzuar bashkë me dokumentacionin

Nxënësit e ardhur nga jashtë vendi, të cilët duan të vijojnë studimet në IAL-të, në vendin tonë, duhet të dërgojnë në rrugë postare, ose të dorëzojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, dokumentet si më poshtë:

1. Formulari i aplikimit për njëvlershmëri.
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.
3. Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dëftesave të të gjitha viteve të shkollimit dhe diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit ose, në mungese të dëftesave, kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e listës së notave të arsimit të mesëm të lartë.
4. Kopje e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dokumentit që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

Formulari, **Kërkesë për aplikim për njësimin e diplomës së shkollës së mesme(për punësim)**, që duhet plotësuar dhe dorëzuar për punësim bashkë me dokumentacionin.

Dokumentacioni për njëvlershmërinë për punësim në Republikën e Shqipërisë, dorëzohet ose dërgohet përmes shërbimit postar në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, nga aplikanti ose nga institucioni i interesuar punëdhënës. Dokumentet për njëvlershmërinë për punësim, janë:

1. Formulari i aplikimit për njëvlershmëri.
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.
3. Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë.

Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

Dorëzimi i dokumenteve kryhet gjatë gjithë vitit.